Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 28-24
Tarih Dt. 23-02-2024

| | |
|---|---|
| TARİH: DATË/A: | 23.02.2024 |
| REFERANS:REFERENC-Ë: | ZKF/012-24 |
| KİME/PËR/ZA/TO: | z.Nysret Koca, Zëvdësues i Drejtorit të Pergjithshëm të Thesarit-MFPT |
| CC: | Zyra Kombëtare e Auditimit |
| KİMİNÖNERİSİYLE/PËRMES/ PREKO/THROUGH: | Abdülhadi Krasniç, Kryetar i Komunës së Mamushës |
| KİMDEN/NGA/OD/FROM: | Xhevahire Gashi, Zyrtar Kryesor Financiar, Komuna e Mamushës |
| KONU/TEMA/SUBJKAT/SUBJEKT: | Korigjimi i Raportit Vjetor Financiar për vitin 2023 |

I nderuar Zv.Drejtor z.Koca,

Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim korigjimin Raportit Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2023.

Të bëhet korrigjimi PVF 2023, me rekomandimin e Auditorëve si në vijim:

- Shpalosje në tabelë për shënimin 2 Paga dhe shtesa, shpenzimet sipas kategorisë ekonomike dhe burimit të fondeve.
- Shpalosje në tabelë për shënimin 3 Mallra dhe shërbime , shpenzimet sipas kategorisë ekonomike dhe burimit të fondeve.
- Shpalosje në tabelë për shënimin 4 Shpenzime komunale, shpenzimet sipas kategorisë ekonomike dhe burimit të fondeve.
- Shpalosje në tabelë për shënimin 5 Subvencione dhe transfere, shpenzimet sipas kategorisë ekonomike dhe burimit të fondeve.
- Shpalosje në tabelë për shënimin 6 Shpenzime kapitale, shpenzimet sipas kategorisë ekonomike dhe burimit të fondeve.
- Shpalosje në tabelë për shënimin 8 Të hyrat tatimore, pranimet sipas kategorisë ekonomike dhe burimit të fondeve.
- Shpalosje në tabelë për shënimin 9 Të hyrat jo tatimore, pranimet sipas kategorisë ekonomike dhe burimit të fondeve.
- Korigjimi tek Neni 19.3.2 Pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1,000 Euro), pasi që është vërejtur që ka qenë një gabim dhe është korigjuar. Shpalosje detaje në formë tabelare sipas vlerës fillestare, zhvlersimit të tanishëm, zhvlersimit të akumuluar, vlerës në libër.

Të bashkangjitur gjeni kopjën elektronike dhe fizike të nënshkruar dhe protokoluar.

**Shënim: Të njëjat i dërgohen njëkohësisht Zyrës Kombëtare të Auditimit.**

Me respekt,

Republika e Kosovës – KosovaCumhuriyeti
RepublikaKosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

# Raporti Vjetor Financiar

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 28-24
Tarih/Dt. 23.02.2024

Neni 12
DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: z.Nysret Koca, U.D. i Drejtorit të Përgjithshëm i Thesarit

Nga: Abdülhadi Krasniç, Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)

Xhevahire Gashi, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116,Ligjin nr. 04/L-194,Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.
Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023 dhe është pjese përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.

- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.

- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.

- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2023.

- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatore të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.

- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare

- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrën e duhur.

- Të gjitha huatë e pranuara janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi

- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023 të institucionit Komuna e Mamushës.

Data: 23/02/2024

(Nënshkrimi i ZKA)

Datë: 23/02/2024

(Nënshkrimi i ZKF)